

MBIKËQYRJA POLICORE



REVISTA E “AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE” NR. 3

Drejtori i Përgjithshëm z. Florian Sulejmani priti në takim Ambasadorin në detyrë të SHBA, z. David Wisner



**Mbikëqyrja nëpërmjet
vettingut për vlerësimin
kalimtar dhe periodik**

**Mbikëqyrja nëpërmjet
veprimtarisë
procedurale penale**

**Mbikëqyrja nëpërmjet
hetimit administrativ të
ankesave e kryerjes së
inspektimeve**

Mediat dhe institucionet publike:
info@amp.gov.al
Punoi: Hervis Nakuçi
Tel: 0694118209
Redaktoi: Ferjola Agolli
Tel: 0695447570



Revista
“MBIKËQYRJA POLICORE”
është botim i Agjencisë së
Mbikëqyrjes Policore

PËRMBAJTJA

Faqja 3 - Drejtori i Përgjithshëm z. Florian Sulejmani priti në takim Ambasadorin në detyrë të SHBA, z. David Wisner

Faqja 4 - SHBA partner kyç në mbështetjen dhe rritjen profesionale të drejtuesve dhe punonjësve të AMP

Faqja 5 - 6 - Intervistë me Drejtorin e Drejtorisë së Inspektimit dhe Ankesave, z. Sterjo Gollosi

Faqja 7 - Mbikëqyrja nëpërmjet hetimit administrativ të ankesave e kryerjes së inspektimeve

Faqja 8 - ICITAP dhuron pajisje kompjuterike për sektorin e inspektimit

Faqja 9 - AMP dhe IPK kryejnë inspektime të përbashkëta

Faqja 10 - Mbikëqyrja nëpërmjet vettingut për vlerësimin kalimtar dhe periodik

Faqja 11 - ONM dhe ICITAP trajnim të përbashkët për punonjësit e AMP mbi procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik

Faqja 12-13-14 - Mbikëqyrja nëpërmjet veprimtarisë proceduriale penale

Faqja 15 - AMP zbaton planin e masave për monitorimin e strukturave të Policisë së Shtetit në pikat e kalimit kufitar

Faqja 16 - Menaxhimi i shërbimeve mbështetëse dhe performanca financiare

Faqja 17 - Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional rajonal dhe ndërkombëtar

Faqja 18 - Digjitalizimi dhe informatizimi

Faqja 19 - 20 dhe 21 - Forcimi i marrëdhënieve dhe rritja e transparencës në bashkëpunimin me qytetarët

Faqja 22 - Prioritetet/objektivat për 6 - mujorin e dytë

Faqja 23 - Harta e drejtorive rajonale të AMP

Faqja 24 - Mënyrat e komunikimit me qytetarët

Në këtë botim do të gjeni të dhëna statistikore nga puna e sektorëve të veçantë në AMP, lajme nga aktivitete të ndryshme të zhvilluara në kuadër të përgjegjësisë ligjore, si edhe informacione të tjera për mediat dhe publikun.



DREJTORI I PËRGJITHSHËM Z. FLORIAN SULEJMANI PRITI NË TAKIM AMBASADORIN NË DETYRË TË SHBA, Z. DAVID WISNER

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Florian Sulejmani priti në takim të Ngarkuarin me Punë i Ambasadës së SHBA-së, z. David Wisner, së bashku me Atasheun për Asistencë në Çështjet e Zbatimit të Ligjit, drejtuesin e ICITAP në Shqipëri, z. Richard Deasy dhe Këshilltaren Ligjore Rezidente të OPDAT, znj. Mary Kate Butterfield.

Ambasadori në detyrë i SHBA-së, z. Wisner uroi z. Sulejmani për marrjen e detyrës duke shprehur vlerësimet maksimale për procesin transparent dhe mjaft cilësor të përzgjedhjes së drejtuesit të agjencisë. Ai garantoj mbështetjen e palëkundur të SHBA-së për të rritur kapacitetet e agjencisë nëpërmjet asistencës teknike dhe trajnimeve të vazhdueshme të personelit, në funksion të zbatimit të ligjit dhe përmbushjes së pritshmërive të publikut.

Drejtori i Përgjithshëm z. Sulejmani shprehu mirënjohjen për mbështetjen bujare dhe vendimtare të Shteteve të Bashkuara për vendin tonë, sidomos në përmbushjen e misionit për mbikëqyrjen civile, trajtimin e shkeljeve të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit përmes programeve ICITAP dhe OPDAT.

Më tej ai tha se agjencia po jep një kontribut të madh në këtë drejtim, nëpërmjet hetimeve proaktive dhe bashkëpunimit me SPAK dhe Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm. Gjithashtu Sulejmanni theksoi rëndësinë e procesit të vlerësimit kalimtar e periodik, atribut dhe përgjegjësi e agjencisë, si një nga mekanizmat e vetëpastrimit me qëllim rritjen e besimit të publikut tek Policia e Shtetit dhe forcimin e integritetit brenda rradhëve të saj.

Në përfundim të takimit, Drejtori i Përgjithshëm, Florian Sulejmani i dorëzoi të Ngarkuarit me Punë në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, z. Wisner dhe Këshilltares Ligjore Rezidente të OPDAT, znj. Mary Kate Butterfield nga një dhuratë simbolike me stemën e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

SHBA PARTNER KYÇ NË MBËSHTETJEN DHE RRITJEN PROFESIONALE TË DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË AMP

Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe agjencitë ligjzbatuese vazhdojnë të jenë një nga partnerët më të rëndësishëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ku nëpërmjet programeve si ICITAP apo OPDAT, kanë kontribuar në rritjen e kapaciteteve teknologjike ashtu edhe në rritjen profesionale të drejtuesve dhe punonjësve të agjencisë.

Në këtë kontekst, kreu i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Florian Sulejmani mori pjesë në trajnimin e mbajtur nga Departamenti Amerikan i Akademisë së Udhëheqjes së Sigurisë Kombëtare (DHSLA), Sesioni i 19-të, nga 22 Prill deri në 2 Maj 2024, në Kampusin e Qendrës Federale të Trajnimit për Zbatimin e Ligjit (FLETC) në Glynco, Georgia.

Drejtori i Përgjithshëm është i pari funksionar ekzekutiv shqiptar i zbatimit të ligjit që ka ndjekur trajnimin e avancuar në Qendrën Federale të Trajnimit për Forcat Ligjzbatuese (Federal Law Enforcement Training Center).

Programi u fokusua në disiplinat e zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe ndërveprimin e tyre me misionin dhe kulturën e zbatimit të ligjit si, aftësitë e lidershitpër më të kuptuarit dhe përshtatjes me sjelljet njerëzore, aftësitë e komunikimit, ndërtimin e ekipit, menaxhimin e konfliktit, menaxhimin e burimeve njerëzore, përgjegjësitë ligjore, menaxhimin e stresit, diversitetin e vendit të punës, aftësitë e performancës, të folurit në publik dhe aftësitë e vendimarrjes në situatë.

Gjithashtu në funksion të rritjes dhe përmirësimit të veprimtarisë inspektuese, ICITAP zhvilloi një trajnim 8 – javor për punonjësit e agjencisë, të cilët u njohën me format më të reja mbi organizimin e inspektimeve.

Në nisje të këtij trajnimi, Atasheu për Asistencën në Çështjet e Zbatimit të Ligjit dhe njëkohësisht përfaqësues i programit ICITAP, z. Richard Deasy, u shpreh se ky trajnim do të shërbejë rrugës së Shqipërisë për reformën në drejtësi, pasi një nga treguesit e demokracisë në një shtet modern është aftësia dhe gadoishmëria për të kërkuar llogari ndaj punonjësve mbi zbatimin e ligjit.



Nga ana e tij, Drejtori i Përgjithshëm z. Florian Sulejmani tha se ky trajnim është një vlerë e shtuar, jo vetëm si shprehje e partneritetit të vazhdueshëm dhe thellim i bashkëpunimit me Programin ICITAP, në kuadër të reformimit dhe përmirësimit të kapaciteteve profesionale të Agjencisë, por edhe në funksion të përmbushjes së standardeve të EPAC (Partnerët Europian Kundër Korrupsionit), organizatë tek e cila AMP është e anëtarësuar prej vitit 2007.

INTERVISTË ME DREJTORIN E DREJTORISË SË INSPEKTIMIT DHE ANKESAVE, Z. STERJO GOLLOSHI



Cili është roli i veprimtarisë inspektuese në AMP dhe si ndërthuret kjo me trajtimin e ankesave?

Inspektimi si instrument mbikëqyrës është krijuar me Ligjin Nr. 10 002, Datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme”. Fillimisht përbëhej nga dy sektorë dhe pas ristrukturimeve dhe ndryshimeve të bëra me Ligjin Nr. 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, dhe Ligjin 128/2021 “Për Agjencinë e

Mbikëqyrjes Policore”, aktualisht drejtoria përbëhet nga 3 sektorë, përkatësisht: Sektori i Inspektimit të Përgjithshëm, Sektori i Trajtimin të Ankesave dhe Sektori i Pritjes së Qytetarëve.

Në 15 vjet funksionim, struktura inspektuese i është nënshtruar ndryshimeve dhe në mënyrë të vazhdueshme që prej krijimit dhe aktualisht trajnohet nga partnerë ndërkombëtarë të misionit ICITAP (Programi Ndërkombëtar i Ndihmës për Trajnimet për Hetimet Penale”, Departamenti i Drejtësisë, SHBA). Referuar kuadrit ligjor, kjo veprimtari ushtrohet nëpërmjet inspektimeve të planifikuara dhe të paplanifikuara.

Sa i përket ankesave, duke marrë në konsideratë objektin dhe metodologjinë, procedura e trajtimit të një anese, në vetvete është inspektim i paplanifikuar. Klasifikohen si të tilla, pasi shtetas, institucione ose subjekte privatë, paraqesin një shqetësim ose problematikë të caktuar, për trajtimin e të cilave kryhen të gjitha verifikimet përkatëse dhe pas vlerësimit e analizimit, nxirren përfundimet përkatëse. Pra, procedura e trajtimit të një anese është një inspektim i mirëfilltë dhe për këtë arsye, struktura përgjegjëse për trajtimin dhe menaxhimin e ankesave është pjesë e Drejtorisë së Inspektimit.

Cila është procedura që ndiqet për trajtimin e ankesave në AMP?

Procedura e trajtimit të ankesave në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, përveç parashikimeve në ligj dhe rregullore, normohet me Procedurat Standarde të Punës “Për pranimin, administrimin dhe trajtimin e ankesave”.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me misionin e veprimtarisë së saj dhe kushtet e sotme të teknologjisë, burimet e hapura të informacionit i konsideron si një nga elementët kryesorë. Për këtë qëllim shfrytëzohen të gjitha burimet e mundshme të sigurimit të informacionit, ku ndër më kryesoret përmendim:

- Ankesat e qytetarëve, për të cilat është krijuar mundësi e plotë nëpërmjet, linjës së gjelbër (numrit 0 800 90 90; numri 06941 51 511 me aplikacion Whatsapp; Email-it në adresën ankesa@amp.gov.al; me postë; si edhe nëpërmjet paraqitjes fizike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AMP-së, apo edhe në strukturat vendore në çdo njësi policore.
- Monitorimi i medias së shkruar dhe elektronike
- Monitorimi i rrjeteve sociale, etj.

Sa i përket procedurës së trajtimit të ankesës, vlen të theksohet se baza e veprimtarisë inspektuese në çdo rast është kontaktimi me shtetasit, me qëllim sigurimin e informacionit të plotë dhe të dhënave të nevojshme.

Sipas procedurës së punës, specialistët përgjegjës për trajtimin e rastit, pas vlerësimit dhe analizimit të problematikës dhe pretendimeve të ngritura, kryejnë hetim administrativ dhe në varësi të përfundimeve;

- Në rastet kur konstatohen elementë të veprës penale, pezullohet hetimi administrativ dhe vijohet me atë penal sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, duke i kthyer përgjigje ankuesit/iniciuesit.
- Në rastet kur konstatohen shkelje të karakterit administrativ, në varësi të kategorisë së tyre, bëhet rekomandimi për Komisionin e Disiplinës së AMP-së ose strukturat përgjegjëse të disiplinës pranë subjekteve dhe i kthehet përgjigje ankuesit/iniciuesit.
- Në rastet kur rezulton se problematika ka ardhur për shkak të mangësive ligjore ose si rezultat i problemeve strukturore, atëherë përpilohet informacioni me rekomandimet përkatëse për marrje masash, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse dhe autoritetit epror të saj.
- Në rastet kur rezulton se procedura ka qenë në përputhje me kuadrin ligjor, i kthehet përgjigje ankuesit/iniciuesit, duke paraqitur në mënyrë shteruese të gjitha verifikimet dhe argumentimin ligjor.

Bazuar në raportet e brendshme periodike, cili ka qenë reagimi i qytetarëve për procedurën dhe përgjigjen që marrin pas trajtimit të rasteve?

Prej vitit 2014 që AMP e ka përfshirë trajtimin e ankesave si një ndër shtyllat bazë të funksionimit të saj, në kuadër të përmirësimit të shërbimit për qytetarët, nëse i referohemi raporteve, çdo vit është shënuar rritje e numrit të telefonatave në linjën e gjelbër dhe në numrin e ankesave të qytetarëve. Nga analizat e kryera rezulton se shifrat tregojnë rritjen e besimit të qytetarëve tek Agjencia.

Kështu, nëse i referohemi në aspekt krahasimor periudhës 6 mujore (2023-2024) rezulton:

- Në fushën e hetimit administrativ, për periudhën Janar – Qershor 2024 janë administruar gjithsej **812 ankesa**, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kur janë administruar **604 ankesa**, konstatohet se ka një rritje me afro **26 %**.
- Në përfundim të hetimit administrativ ka rezultuar se në **81 raste, ankesat kanë qenë të bazuara**, duke shënuar një rritje me afro **11%** në krahasim me vitin 2023 (me 73 raste)

Tipologjia më e shpeshtë e ankesave ndaj subjekteve që drejtojnë AMP?

Nëse i referohemi tipologjisë së ankesave, referuar raporteve dhe analizave rezulton se numri më i madh i ankesave është për strukturat e Policisë së Shtetit dhe kryesisht për ato të policisë rrugore dhe shërbimet e rendit.

Mbizotërojnë kryesisht ankesat që lidhen me procedurat e ndjekura për vendosjen e masave administrative, menaxhimin e konflikteve dhe shoqërimin e shtetasve në ambientet policore.

Nga analizimi dhe vlerësimi rezulton se subjekt i ankesave janë kryesisht ato struktura të cilat për shkak të objektit të punës përballen më së shumti me qytetarët.

MBIKËQYRJA NËPËRMJET HETIMIT ADMINISTRATIV TË ANKESAVE DHE KRYERJES SË INSPEKTIMEVE

Hetimi administrativ i ankesave dhe kryerja e inspektimeve zë një fushë të gjerë të kontrollit të strukturave policore, që nga ajo e infrastrukturës ligjore, menaxhimit strukturor, funksional, organizativ, të burimeve njerëzore dhe logjistike, e deri tek lidhshipi, etika, sjellja individuale dhe kolektive e policisë.

Forcimi dhe rritja e cilësisë së trajtimit të ankesave dhe inspektimit nuk qëndron tek numri i ankesave të trajtuara e inspektimeve të kryera, më shumë apo më pak, por tek problematikat / tematikat për të cilën shqyrtohen ankesat dhe kryhen inspektimet, si dhe tek cilësia e gjetjeve / konkluzioneve dhe rekomandimeve që iu jepen strukturave objekt inspektimi.

Rezultatet e 6 - muorit të parë të vitit 2024



Janë dhënë 133 **rekomandime** për përmirësimin e situatës

- 54 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
- 79 punonjës policie të nivelit zbatues

Punonjësit për të cilët është rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor të ndarë sipas shërbimeve të policisë

- 51 punonjës të strukturave të policisë rrugore
- 43 punonjës të strukturave të rendit dhe sigurisë publike
- 24 punonjës të strukturave të hetimit të krimit
- 9 punonjës të strukturave të kufirit & migracioni
- 5 punonjës të strukturës së posaçme “Shqiponja”
- 1 punonjës i strukturave të Gardës së Republikës

Rekomandimet për fillimin e hetimit disiplinor për “shkelje të rëndë” janë adresuar pranë Komisionit Disiplinor të Agjencisë, ndërsa “për shkelje të lehtë” janë adresuar pranë Drejtorisë së Standardeve Profesionale në Policinë e Shtetit. Kryesisht, ankesat e qytetarëve evidentojnë shkelje të karakterit administrativ, më së shumti në ato struktura që janë në vijën e parë të veprimit dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun, siç janë **strukturat e Sigurisë Publike, Policisë Rrugore apo Hetimit të Krimit**.



ICITAP DHURON PAJISJE KOMPJUTERIKE PËR SEKTORIN E INSPEKTIMIT

Në ambientet e Ministrisë së Brendshme u mbajt ceremonia e dhurimit të pajisjeve kompjuterike të fjalës së fundit nga partnerët amerikanë, në dispozicion të specialistëve të Sektorit të Inspektimit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.

Në këtë ceremoni ishte i pranishëm Ministri i Brendshëm z. Taulant Balla, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Florian Sulejmani, Drejtori i Byrosë për Çështjet e Drogave dhe Zbatimit të Ligjit (Departamenti i Shtetit) për Shqipërinë, z. John Kastning, zyrtarë të tjerë të lartë të Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve të varësisë dhe drejtues të ICITAP.

Ministri Balla vlerësoi punën e AMP gjatë muajve të fundit, duke vënë në pah shtimin e numrit të referimeve të agjencisë në prokurori, tregues pozitiv në rritjen e besimit të publikut ndaj AMP. Ministri gjithashtu bëri një thirrje për publikun vendas apo vizitorët e huaj që të denoncojnë çdo shkelje nga ana e punonjësve të policisë.

Në fjalën e tij Drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Sulejmani shprehu falenderime ndaj qeverisë së SHBA dhe agjencive ligjzbatuese amerikane për mbështetjen e vazhdueshme që kanë dhënë deri më sot, për rritjen e kapaciteteve teknologjike të AMP.

“Bashkëpunimi me Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm, me të gjitha agjencitë e tjera ligj zbatuese të ligjit dhe të inteligjencës dhe natyrisht me partnerët tanë ndërkombëtare, ndër të cilët ICITAP-i është në krye të punës, ka forcuar akoma më shumë rolin e AMP në funksion të garantimit të standardeve të larta të integritetit dhe të pastërtisë së figurës të punonjësve të policisë si edhe për ta kthyer Policinë e Shtetit në institucionin më të besuar në vend. Faleminderit partnerëve për mbështetjen”, përfundoi Sulejmani.

AMP DHE IPK KRYEJNË INSPEKTIVE TË PËRBASHKËTA

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Mbi forcimin e bashkëpunimit të Kontrollit të Brendshëm”, u realizua inspektimi i përbashkët nga strukturat inspektuese të agjencive tona.

Tematika e këtij inspektimi ishte “*Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar*”.

Inspektimi u zhvillua në tre Pika të Përbashkëta të Kalimit Kufitar, të menaxhuara nga Policia e Kosovës dhe Policia e Shtetit, dhe në Raportin e Përbashkët të Inspektimit, u pasqyruan këto rekomandime për përmirësim nga strukturat përgjegjëse të Policive të dy vendeve tona, e konkretisht:

- zbatimit më me korrektësi të Marrëveshjes së datës 29.12.2018 mbi respektimin e kritereve të parimit “një ndalesë një kontroll”;
- pajisjen e PPKK-ve me logjistikën orientuese/informuese për udhëtarë;
- përmirësimin e infrastrukturës së kabinave të kontrollit;
- studimit të dinamikës së punës;
- plotësimin të strukturës organike;
- kalimit në kohë reale të të dhënave nga sistemet informative të të dyja policive;
- rritjen e aktivitetit parandalues të krimit ndërkufitar;
- rritjen e bashkëpunimit nëpërmjet kryerjes së analizave të përbashkëta të riskut
- organizimin e operacioneve të përbashkëta.



Gjithashtu për të thelluar më tej bashkëpunimin rajonal në fushën e mbikëqyrjes, me mbështetjen e programit ICITAP, u organizua konferenca rajonale me temë “Fuqizimi i bashkëpunimit të shërbimeve të kontrollit të brendshëm në Ballkanin Perëndimor përmes shkëmbimit të praktikave të mira”. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin zyrtarë të lartë nga institucionet homologe të mbikëqyrjes policore të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, njëherazi edhe anëtare të Forumit Rajonal të Agjencive të Mbikëqyrjes Policore.

Pjesë e diskutimit ishte shkëmbimi i përvojave dhe ideve të avancuara për fuqizimin e integritetit në fushën e kontrollit policor si edhe vazhdimësia e aktiviteteve të përbashkëta inspektuese.

Në mbyllje të konferencës të gjithë pjesëmarrësit dakordësuan zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta, organizimi i trajnimeve mes vendeve të rajonit dhe krijimi i programeve të shkëmbimit të përvojave të mira në kuadër të Forumit Rajonal të Agjencive Mbikëqyrëse Policore.

MBIKËQYRJA NËPËRMJET VETTINGUT PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK

Procesi i Vettingut, me të dy komponentët e tij, atë të Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë, është një proces i rëndësishëm, qëllimi kryesor i të cilit është *“dhënia e kontributit real për afirmimin e punonjësve profesionistë dhe me integritet të lartë të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, nëpërmjet zbatimit të parimit të integritetit, rritjes profesionale dhe garantimit të një karriere të drejtë dhe të bazuar në meritokraci, duke krijuar në vazhdimësi institucione të forta dhe të besueshme”*.

Më 5 Prill 2023 u zhvillua shorti i parë i ndarjes së trupave të vlerësimit si dhe i 36 subjekteve të listës së parë, në funksionet Drejtor Drejtorie në nivelin qendror dhe vendor, ku u shortuan 30 subjekte nga Policia e Shtetit, 2 subjekte nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe 2 subjekte nga Garda e Republikës.



Më 4 Korrik 2023, u zhvillua shorti i dytë i ndarjes së trupave të vlerësimit si dhe i 36 subjekteve të listës së dytë, në funksionet Drejtor dhe Zv/Drejtor Drejtorie në nivel qendror dhe vendor, ku u shortuan 30 subjekte nga Policia e Shtetit, 4 subjekte nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe 2 subjekte nga Garda e Republikës. Trupat e vlerësimit administruan dosjet e subjekteve të listës së parë dhe të dytë dhe dërguan formularët drejt institucioneve respektive.

Pra 72 subjekte në total që konsistojnë konkretisht:

- 60 subjekte nga Policia e Shtetit, në funksionet Drejtor Drejtorie në nivel qendror dhe vendor
- 8 subjekte nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në funksionet Drejtor Drejtorie në nivel qendror dhe vendor
- 4 subjekte nga Garda e Republikës, në funksionet Drejtor Drejtorie.

Pas hetimit administrativ të procesit të vlerësimit kalimtar te tre komponentët “figura, pasuria dhe profesionalizmi”, Trupat Vlerësuese për periudhën Janar-Qershor 2024 kanë zhvilluar seancat dëgjimore dhe seancat për dhënie vendimi për 39 subjekte:

- 27 Vendime për “konfirmim në detyrë” të subjektit të vlerësimit.
- 1 Vendim për largimin nga funksionet e përcaktuara në nenin 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- 6 Vendime për “ndërprerje të procesit të vlerësimit kalimtar” pasi “pozicioni i punës është jashtë fushës së ushtrimit”.
- 1 Vendim për “përfundim nga detyra”.

Ndërkohë vazhdon hetimi administrativ për subjektet e vlerësimit kalimtar për të dy listat.

ONM DHE ICITAP: TRAJNIM TË PËRBASHKËT ME PUNONJËSIT E AMP MBI PROCESIN E VLERËSIMIT KALIMTAR DHE PERIODIK

Punonjësit e Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik morën pjesë në trajnimin e organizuar nga ONM (Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit), me mbështetjen edhe të programit ICITAP.

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Florian Sulejmani falenderoi partnerët për mbështetjen e vazhdueshme, duke theksuar se agjencia po i kushton një vëmendje shumë të madhe procesit të vlerësimit kalimtar e periodik, pasi konsiderohet hallka kyçe në sigurimin e institucioneve të forta e të besueshme, me profesionistë me integritet.



Vëzhguesi Ndërkombëtar i ONM-së nga Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara, z. Steven Kessler, së bashku me përfaqësues të ONM-së ndanë me anëtarët e trupave vlerësuese të AMP-së, përvoja dhe praktika disa vjeçare të fituar nga procesi i vetingut të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Ndërkohë Atasheu për Asistencën në Çështjet e Zbatimit të Ligjit në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, z. Richard Deasy, vlerësoi nivelin shumë të lartë të profesionalizmit që punonjësit e Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik kanë treguar gjatë seancave të vetingut, në të gjitha proceset që janë objekt vlerësimi.

Një nga çështjet që ju dha vëmendje ishin edhe sfidat e hasura gjatë zhvillimit të këtij procesi, që nga fshehja e mundshme e pasurisë nga subjektet, hetimi i kontrollit të figurës, llogaridhënia gjatë hetimit dhe mbi të gjitha transparenca e procesit. Një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim do të luajnë edhe integrimi i praktikave dhe përvojave të parashtruara nga partnerët amerikanë, të cilat do të përshtaten me mundësitë dhe kushtet e një vendi si Shqipëria.



Nga ana e tij, Këshilltari i Lartë për Llogaridhënien Policore nga Programi ICITAP, z. Richard Bates, përmendi edhe testin e poligrafit, si një vlerë e shtuar dhe një instrument shumë i vlefshëm kundër “gënjeshtrave dhe korrupsionit”. Përfaqësuesit amerikanë garantuan mbështetjen e SHBA ndaj misionit të zbatimit të ligjit, duke sugjeruar zhvillimin e testit të poligrafit në të gjitha strukturat e posaçme të antikorrupsionit.

MBIKËQYRJA NËPËRMJET VEPRIMTARISË PROCEDURIALE PENALE

Hetimi procedural penal është një nga shtyllat kyçe të veprimtarisë së Agjencisë dhe në këtë kontekst, hetimi procedural penal ka arritur nivele shumë të kënaqshme, sidomos në cilësi, por edhe në evidentimin e veprave penale të përcaktuara si prioritare, apo fenomene shqetësuese. Treguesit e veprimtarisë procedurale penale reflektohen në të dhënat e mëposhtme:

Në këtë 6-mujor të parë të vitit **2024**, nga strukturat e hetimit të Agjencisë janë referuar pranë organit të ndjekjes penale në Prokurori **151 materiale procedurale, për 240 punonjës të strukturave;**

Sipas nivelit drejtues	1	•punonjës policie të nivelit drejtues
	57	•punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues
	174	•punonjës policie të nivelit zbatues
	1	•punonjës administrativ
	5	•efektivë të Gardës
	2	•punonjës të PMNZSH
	31	•shtetas

Janë kryer me iniciativë ndalimet / arrestet në kushtet e flagrancës si dhe ekzekutuar vendimet e gjykatave për masat e sigurisë të karakterit ndalues dhe shtrëngues të dhëna ndaj 55 punonjësve të strukturave e 19 shtetasve

Arrestuar / ndaluar në flagrancë 22 persona, nga të cilët:	2	•punonjës policie të nivelit të parë drejtues
	5	•punonjës poilicie të nivelit zbatues
	2	•efektivë të Gardës
	13	•shtetas

Masa e sigurimit personal "arrest me burg" caktuar për 8 persona nga të cilët:	1	•punonjës policie i nivelit të parë drejtues
	3	•punonjës policie të nivelit zbatues
	4	•shtetas

Masa e sigurimit personal "arrest në shtëpi" caktuar për 4 persona nga të cilë	4	•punonjës policie të nivelit zbatues
---	---	--------------------------------------

Masa e sigurimit personal "detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" caktuar për 4 persona nga të cilët;	4	•punonjës policie të nivelit zbatues
---	---	--------------------------------------

Masa e sigumit personal "pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik" caktuar për 37 persona , nga të cilët;	1	• punonjës policie niveli madhor
	2	• punonjës policie niveli i mesëm
	11	• punonjës policie i nivelit të parë drejtues
	22	• punonjës policie të nivelit zbatues
	1	• punonjës administrativ (civil)

Masa e sigurimit personal “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” caktuar për **3 persona** nga të cilët;

1 {
2 {

•punonjës policie i nivelit të zbatues

•shtetas


Janë kryer me iniciativë ndalimet / arrestet në kushtet e flagrancës si dhe ekzekutuar vendimet e gjykatave për masat e sigurisë të karakterit ndalues dhe shtrëngues të dhëna ndaj 55 punonjësve të strukturave e 19 shtetasve. Gjatë këtyre 6 muajve të parë të këtij viti është synuar rritja e eficiencës së hetimeve proaktive në funksion të goditjes së paligjshmërive në rradhët e strukturave që janë objekt i mbikëqyrjes, kryesisht të Policisë së Shtetit, duke synuar jo vetëm në nivel zbatues / operacional, por dhe nivelet e para, të mesme dhe të larta të menaxhimit.

Gjithashtu një vëmendje e veçantë i është kushtuar strukturave me risk të lartë korrupsioni, si kufiri, policia rrugore, hetimi i krimit, shërbimet ndaj të tretëve, etj. Konkretisht në këtë periudhë kemi pasur 151 referime me 240 punonjës të referuar, krahasimisht me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ku ka pasur 107 referime me 149 punonjës të referuar, pra ka një rritje me:

- 41% të numrit të referimeve penale
- 61% të numrit të punonjësve të referuar
- 71% të numrit të hetimeve proaktive


Periudha	Referime		Nr. punonjësish	Nr. Punonjësve të Policisë				Garda	PMNSH	Shtetas
	Total	Hetime proaktive		Mesëm Drejtues	Parë drejtues	Zbatues	Administrativë			
Janar – Qershor 2023	107	35	149	-	45	96	4	1	3	28
Janar – Qershor 2024	151	60	240	1	57	174	1	5	2	31

TREGUES KRAHASIMOR



Ndërkaq referimet penale të ndara sipas Drejtorive Rajonale dhe Qëndrore;

Referime penale sipas Drejtorive Rajonale dhe Qëndrore



■ Nr. Referimesh ■ Nr. Punonjësish të referuar ■ Nivel i mesëm drejtues
■ Niveli i parë drejtues ■ Niveli zbatues ■ Administrativë
■ Garda ■ PMNZH ■ Shtetas

AMP ZBATON PLANIN E MASAVE PËR MONITORIMIN E STRUKTURAVE TË POLICISË SË SHETIT NË PIKA TË KALIMIT KUFITAR

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në kuadër të Planit të Masave “Për monitorimin e veprimeve të strukturave që janë subjekt i veprimtarisë së Agjencisë gjatë festave të fund vitit” ka monitoruar veprimet e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së detyrës në strukturat e;

- o Pikës së Kalimit Kufitar “Aeroporti Rinas”,
- o Pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë, në Gjirokastrë,
- o Pikës së Kalimit Kufitar Qafë Thanë,
- o Pikës së Kalimit Kufitar Port Durrës,
- o Pikës së Kalimit Kufitar, në Shkodër,
- o Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.



Monitorimi u fokusua në mbikëqyrjen e veprimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së detyrës funksionale në përgjithësi dhe veprimeve në Hyrje – Dalje të shtetasve, në veçanti.

Gjithashtu punonjës të agjencisë kontaktuan me shtetas të ndryshëm, të cilët pasi dhanë opinionet e tyre për procedurën dhe sjelljen e punonjësve të policisë, u njohën edhe me veprimtarinë dhe rolin AMP-së në funksion të zbatimit të ligjit dhe vetëpastrimit.



Qytetarëve iu shpërndanë edhe materiale informuese, ku paraqiten mënyrat e ndryshme të komunikimit me Agjencinë, ndërsa ata u inkurajuan që të denoncojnë çdo rast korruptiv apo shkelje të ligjit nga ana e punonjësve të policisë.

Në vijim të monitorimit në pikat kufitare, jo vetëm për periudha fluksi por edhe monitorime rutine, fokusi do të jetë në problematika dhe fenomene evidente të dala gjatë përmbushjes së veprimtarisë së institucionit.

AMP trajnim nga OSBE mbi etikën, të drejtat e njeriut, korrupsioni dhe praktikat procedurale e hetimore

Punonjës të Agjencisë të Mbikëqyrjes Policore morën pjesë në trajnimin e organizuar nga OSBE, të fokusuar tek etika, të drejtat e njeriut, korrupsioni dhe praktikat procedurale e hetimore në punën e Agjencisë.

Darko Angelov, Drejtuesi i Departamentit për Bashkëpunimin në Çështjet e Sigurisë në Prezencën e OSBE-së, theksoi rëndësinë e pastrimit të forcave ligjzbatuese nga elementë të korruptuar. Ai garanto mbështetjen e OSBE-së, si partnere afatgjatë e Ministrisë së Brendshme dhe strukturave në varësi të saj.

Duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme të OSBE-së, drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes Police, Florian Sulejmani, tha se trajnimi do të ndihmojë në aftësimin e mëtejshëm profesional të punonjësve të Agjencisë dhe në përmbushjen e misionit të saj.

MENAXHIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PERFORMANCA FINANCIARE

Objektivat dhe prioritet e realizuara për 6-mujorin e parë 2024

- Kryerja e procedurave për përforcimin e godinës dhe shtesë kati në godinën e AMP-së, parashikuar në 2 vite (2023-2024) në vlerën 34,800 mijë lekë. Përfunduar si proces
- Krijimi i programit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe programit Financa 5, në vlerën 2,167 mijë lekë. Në proces lidhje kontrate
- Kryerja e procedurave të mobilimit të shtesë së katit dhe transferimit të pjesës së personelit në godinën qendrore, në vlerën 6,500 mijë lekë. Përfunduar si proces
- Blerje pajisje zyre dhe përgjimi, për nevoja të AMP-së, në vlerën 5850 mijë lekë. Procedurë e realizuar pjesërisht.

Pasqyra e realizimit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar-Qershor 2024. (në lekë)

<i>Nr.</i>	<i>Art.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani</i>	<i>Realizimi</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Real. në %</i>
1.	600	Paga & shpenz. personeli	109,418,000	99,342,097	10,075,903	91%
2.	601	Sig.shoqërore&shëndetësore	19,000,000	16,251,161	2,748,839	86%
3.	602	Mallra e shërbime	36,062,200	24,646,247	11,415,953	68%
4.	606	Transf. buxhetet familjare	6,732,000	3,129,848	3,602,152	46%
5.	231	Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara	11,000,000	6,809,153	4,190,847	62%
TOTALI			182,212,200	150,178,506	32,033,694	82%

- 23 punonjës janë emëruar gjatë 6- muorit të parë të vitit 2024
- 14 punonjës janë larguar gjatë 6- muorit të parë të vitit 2024, nga të cilët:
 - 1 punonjës në pension pleqërie
 - 1 punonjës i larguar me motivacionin: Pranuar në kundërshtim me ligjin 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore
 - 12 Punonjës me motivacionin: kërkesën e tij

Masa disiplinore për punonjësit e AMP-së, nuk ka patur.

RRITJA DHE FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Në kuadër të bashkëpunimit të projektit EU4LEA me Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, Drejtori i Përgjithshëm vizitoi panairin “Intelligence Support Systems World Europe”, i mbajtur në datat 4 – 6 Qershor në Pragë. Ky është event i madh në botën e analistëve rajonale të zbatimit të ligjit, sigurisë publike, luftës kundër trafikut të drogës, pastrimit kibernetik të parave, trafikimit të qenieve njerëzore, terrorizmit dhe aktiviteteve të tjera kriminale.

Me ftesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Drejtori i Përgjithshëm i AMP, z. Florian Sulejmani zhvilloi një takim me homologun, z. Grig Gen Hendrych. Gjatë këtij takimi Sulejmani vlerësoi gadishmërinë për bashkëpunim në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimit të eksperiencave midis dy institucioneve, ndërsa ftoi z. Hendrych të vizitonte institucionin tonë.

Nga ana e tij z. Hendrych vlerësoi punën e deritanishme të agjencisë, ndërsa theksoi nevojën për rritje të bashkëpunimit mes institucioneve për të ndarë eksperiencë në fushën e inspektimeve apo hetimeve proaktive.

Po ashtu në funksion të forcimit dhe rritjes së bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, z. Florian Sulejmani zhvilloi një takim me Kryeshefin e Inspektoratit Policor të Kosovës, z. Kushtrim Hodaj.

Gjatë këtij takimi u nënshkrua Raporti nga Inspektimi i përbashkët, i realizuar nga strukturat inspektuese të agjencive tona, në fushën “Vlerësimi i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës



për ngritjen e Pikave të Përbashkëta të Kalimit Kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar”.

Bashkëpunimi me Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), i cili është konkretizuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të miratuar që në vitin 2015 dhe ka gjetur zbatim në takime periodike ndërmjet dy agjencive tona, shkëmbimit të informacioneve operative për raste të paligjshmërive të evidentuara në radhët e punonjësve të policisë kufitare të të dy vendeve tona, në inspektime të përbashkëta, etj.

Takimi pati fokus edhe shkëmbim praktikave më të mira të punës, një ndër të cilat është edhe sistemi i menaxhimit të ankesave, ku në bashkëpunim dhe me ICITAP do të integrohet edhe në strukturën e vendit homolog.

Bashkëpunimi ndërmjet nesh është duke vazhduar në draftimin dhe miratimin gjatë vitit 2024 të “Statutit të Forumit Rajonal të Organizmave të Kontrollit dhe Mbikëqyrjes Policore”, i cili bën bashkë institucionet homologe të Malit të Zi, Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

DIGJITALIZIMI DHE INFORMATIZIMI

Agjencia ka bërë përpjekje të vazhdueshme për forcimin e kapaciteteve të brendshme të saj nëpërmjet modernizimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, sipas modelit të institucioneve të specializuara të Mbikëqyrjes së Jashtme Policore, të vendeve të BE-së e jo vetëm.

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit, e cila po zhvillohet çdo ditë me hapa galopante, është pjesë integrale dhe e pandashme e veprimtarisë së shërbimeve inteligjente e agjencive ligjzbatuese në vendet e Bashkimit Evropian e jo vetëm, duke standardizuar dhe modernizuar procedurat e punës, rritur cilësinë dhe efikasitetin e rezultateve të tyre.

Kryesisht me fonde buxhetore nga buxheti i shtetit por dhe me donacione të partnerëve tanë (ICITAP), janë ngritur dhe venë në shfrytëzim e përdorim të strukturave të Agjencisë këto rrjete dhe sisteme si vijon:


- *Sistemi i Menaxhimit të Çështjes Moduli i Ankesave & Moduli i Hetimit Procedural Penal. (investimi ICITAP Albania)*
- *Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Ibase (SMI Ibase)*
- *Sistemi IBM i2 ANALYST NOTEBOOK.*
- *Sistemi IBM SPSS STATISTICS*
- *Sistemi – baza e të dhënave për procedurat e CSP*
- *Sistemi – për përgjim Ambiental dhe lokalizim – strukturat operacionale*
- *Sistemi – Arkiva Dixhitale*

Këto sisteme i shërbejnë rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të proceseve informative, analizës së informacionit, hetimit administrativ dhe atij procedural penal që kryhet nga strukturat e agjencisë, ashtu sikurse edhe rritjes së mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë dhe llogaridhënies sipas linjës epror – vartës, për përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësi funksionale të gjithsecilit punonjësi.

Një theks i veçantë i është dhënë edhe sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të agjencisë, kjo për nga natyra e veprimtarisë sensitive dhe konfidenciale që performojnë strukturat e Agjencisë në përmbushje të objektit të veprimtarisë së saj.

Kështu, nëpërmjet prokurimit të klasifikuar me objekt “Blerje pajisje për arkivën dixhitale, ndarjen e saj më vete dhe instalim, konfigurim dhe implementim brenda rrjetit të agjencisë”, u mundësua plotësimi sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këto procedura për rrjetet që qarkullojnë informacion të klasifikuar.

Investimi që është kryer në fushën e teknologjisë së informacionit për rritjen e parametrave të sigurisë dhe zhvillimin e sistemeve kompjuterike është pjesë e vizionit tonë për t’ju përgjigjur dinamikës dhe kërkesave në rritje për sisteme të sigurta dhe të shpejta.



FORCIMI I MARRËDHËNIEVE DHE RITJA E TRANSPARENCËS NË BASHKËPUNIMIN ME QYTETARËT

Agjencia gjatë 6 – mujorit të parë të vitit 2024 ka vijuar fushatën promovuese në disa qytete të vendit, nëpërmjet takimeve me nxënës të shkollave të mesme, studentë dhe qytetarë.

Përfaqësuesit e Agjencisë janë shoqëruar nga Këshilltari i Lartë për Llogaridhënien Policore nga Programi ICITAP në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë Z. Richard Bates, i cili gjatë takimeve ka theksuar mbështetjen e ambasadës amerikane për Agjencinë, në funksion të zbatimit të ligjit dhe garantimit të drejtave të qytetarëve për të pasur një shërbim policor korrekt dhe të standardeve më të larta evropiane. Gjithashtu ai ka vënë theksin tek nevoja për një bashkëpunim më të ngushtë Agjenci – publik, si një prej mënyrave më të rëndësishme për ushtrimin e mbikëqyrjes civile në funksion të pastrimit të Policisë së Shtetit nga çdo paligjshmëri.



Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e Agjencisë kanë prezantuar misionin, objektin e veprimtarisë, organizimin dhe mjetet e komunikimit, ndërsa gjatë bashkëbisedimeve të hapura, është shpjeguar edhe roli e përgjegjësitë e Agjencisë në funksion të një sërë fenomenesh negative, si; lufta kundër korrupsionit, çështje të sigurisë publike apo siguria në shkolla. Nga ana e tyre, studentët shprehën opinionet në lidhje me punën e Policisë së Shtetit, sigurisë në shkolla dhe komunitetin ku ata banojnë.

Më tej, përfaqësuesit e AMP-së zhvilluan takime me qytetarë që udhëtonin përmes Pikave të Kalimit Kufitar. Gjatë këtyre takimeve u prezantuan mënyrat e ndryshme të kontaktit me agjencinë, në funksion të realizimit të misionit të saj, por edhe për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit me qytetarët.

Gjatë këtyre aktiviteteve është vënë theksi tek rritja e bashkëpunimit Agjenci-publik si një element kyç në funksion të llogaridhënies dhe përgjegjëshmërisë, së pari duke nisur nga vetë AMP dhe duke vijuar më pas tek institucionet që janë objekt i veprimtarisë sonë.

Tiranë

Janë organizuar takime me studentë të Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.

Një takim mjaft i frytshëm u zhvillua edhe me studentë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit.



Durrës

Janë organizuar takime me qytetarë, studentë dhe nxënës të maturës në Universitetin “Aleksandër Moisiu” dhe shkollat e mesme “Gjergj Kastrioti” dhe “Rilindja”. Takime u zhvilluan edhe me qytetarë që udhëtonin përmes Portit të Durrësit



Vlorë

Janë organizuar takime me studentë dhe nxënës të maturës në Universitetin “Ismail Qemali” dhe shkollat e mesme “Ali Demi” dhe “Halim Xhelo”



Fier

Janë organizuar takime me nxënës të maturës në shkollat e mesme “Janaq Kilica” dhe “Perikli Ikonimi”

Pogradec

Janë organizuar takime me nxënës të maturës në shkollën e mesme “Muharrem Çollaku”. Takime u zhvilluan edhe me qytetarë që udhëtonin përmes Pikës së Kalimit Kufitar Qafë Thanë



Korçë

Janë organizuar takime me qytetarë, studentë dhe nxënës të maturës në Universitetin “Fan Noli” dhe shkollat e mesme “Themistokli Gërmenji” dhe “Raqi Qirinxhi”. Takime u zhvilluan edhe me qytetarë që udhëtonin përmes Pikës së Kalimit Kufitar Kapshticë



Sarandë

Janë organizuar takime me nxënës të maturës në shkollat e mesme “Hasan Tahsimi” në Sarandë, shkollën e mesme “Sulejman Delvina” në Delvinë dhe shkollën e mesme të bashkuar “5 Dëshmorët”, Ksamil

Gjirokastrë, Përmet dhe Tepelenë

Janë organizuar takime me nxënës të maturës në Universitetin “Eqrem Çabej” në Gjirokastrë dhe shkollën e mesme “Siri Shaplllo” në Gjirokastrë. Takime sensibilizuese janë zhvilluar edhe në shkollën e mesme “Sami Frashëri” në Përmet dhe shkollën e mesme “Abaz Shehu” në Tepelenë.



Shkodër e Lezhë

Janë organizuar takime me nxënës të maturës në shkollën e mesme “28 Nëntori” në Shkodër, ku mori pjesë gjithashtu edhe Drejtori i Përgjithshëm Florian Sulejmani, i cili gjatë bashkëbisedimit theksoi nevojën për një bashkëpunim më të ngushtë agjenci-publik duke ftuar të gjithë qytetarët të denoncojnë çdo rast abuzimi nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit Zjarrfikës. Takime sensibilizuese u zhvilluan edhe në shkollën e mesme “Oso Kuka” në Shkodër, si edhe në shkollën e mesme “Hydajet Lezha” në Lezhë.



Berat, Kuçovë dhe Lushnje

Janë organizuar takime me nxënës të maturës në shkollën e mesme “Kristaq Capo” në Berat, ku mori pjesë edhe Zv. Ministri i Brendshëm Julian Hodaj, i cili në fjalën e tij përgëzoi hapjen e AMP për publikun, si një domosdoshmëri në funksion të bashkëpunimit të ndërsjellë. Duke folur për paketën e sigurisë në shkolla, Hodaj tha se tashmë ka rezultate shumë të kënaqshme në drejtim të rritjes së parametrave të sigurisë, duke theksuar se një nga pikat kyçe të suksesit të kësaj pakete është bashkëpunimi i ngushtë mes institucioneve ligjzbatuese dhe publikut.

Takime të tjera sensibilizuese u zhvilluan edhe me nxënës të maturës në shkollën e mesme “5 Tetori” në Kuçovë dhe shkollën e mesme “18 Tetori” në Lushnje.

Gjatë këtyre takimeve janë shpërndarë edhe 3500 Fletëpalosje, 3000 Kartvizita dhe 300 kopje të Revistës “Mbikëqyrja Policore”.




Aktualisht, në funksion të rritjes dhe forcimit të marrëdhënieve dhe besimit të publikut tek Agjencia, jemi duke punuar për zhvillimin e një sistemi raportimi (Aplikacion) ku çdo qytetar mund ta instalojë në telefonin e tij këtë aplikacion dhe të dërgojë ankesën në kohë reale ndaj subjekteve që mbikëqyren dhe kontrollohen nga ne. Në këtë mënyrë Agjencia synon të jetë sa më pranë qytetarëve në zgjidhjen e problematikave të ndryshme që mund të kenë, kryesisht me punonjës policie, e jo vetëm, në një kohë sa më të shpejtë, me efikasitet dhe efikasitet.

PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR 6 – MUJORIN E DYTË

Në vlerësim të arritjeve të deritanishme dhe treguesve konkretë të punës, sfidat dhe prioritetet kryesore që i janë përcaktuar agjencisë nga Ministri i Brendshëm dhe ato që rrjedhin nga Dokumentet Strategjike afatmesme dhe afatgjata, “Programi Vjetor i Punës 2024” dhe “Strategjia e Zhvillimit të Agjencisë 2020 – 2024 e Plani i Veprimit”:

1. Vijimi i zhvillimit të procesit të Vlerësimit Kalimtar për subjektet objekt vlerësimi dhe fillimi i procesit të Vlerësimit Periodik.
2. Përfundimi i implementimit të ligjit nr. 121/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, nëpërmjet draftimit dhe miratimit të akteve nënligjore që plotësojnë të gjithë infrastrukturën ligjore të agjencisë.
3. Rritja dhe forcimi i rolit mbikqyrës së agjencisë kundër paligjshmërisë ndër rradhët e strukturave, me fokus të veçantë korrupsionin dhe abuzimin me detyrën, nëpërmjet:
 - Forcimit dhe rritjes së bashkëpunimit kryesisht me Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Prokuroritë e Shkallës së Parë, Policinë e Shtetit, SHISH, AISM, ASIKS, etj, me anë të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe si edhe protokolleve të veprimit.
 - Konsolidimit të instrumenteve / mekanizmave të analizës së informacionit, veprimtarisë parandaluese, hetimit administrativ të ankesave dhe inspektimeve, hetimit penal të shkeljeve, procesit të sigurimit të personelit (CSP), për parandalimin, zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë të kryer nga punonjës të strukturave si dhe hetimit disiplinor të subjekteve për shkelje të rënda.
 - Prodhimit të produkteve analitike duke përdorur programet / sistemet e teknologjive bashkëkohore të informacionit, për çështje të zbatimit të ligjit dhe parandalimit të shkeljeve gjatë ushtrimit të detyrës nga subjektet.
 - Forcimit të kapaciteteve të brendshme të agjencisë, nëpërmjet përmirësimit dhe rritjes në sasi e cilësi të infrastrukturës logjistike, teknike, sisteme e programe të teknologjisë bashkëkohore.
4. Proceset Integruese të Shqipërisë në BE / bashkëpunimi ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit. Angazhimi i vazhdueshëm në Grupet Institucionale të Punës për ndjekjen dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga rekomandimet e lëna nga BE për institucionet shqiptare, në kuadër të atarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

HARTA E DREJTORIVE RAJONALE TË AMP



Drejtoria Rajonale AMP Tiranë

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Tiranë ndodhen në ambjentet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Adresa: Rr. Sami Frashëri Nr.5, Tiranë

Drejtoria Rajonale AMP Durrës

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Durrës ndodhen në ambjentet e DVP Durrës.

Adresa: Rr. Aleksandër Goga, Durrës

Drejtoria Rajonale AMP Shkodër - Lezhë

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Shkodër ndodhen në ambjentet e DVP Shkodër.

Adresa: Rr. Lëvizja e Postribës, Shkodër

Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Lezhë

Zyrat e SHÇBA Lezhë ndodhen në ambjentet e DVP Lezhë.

Adresa: Rr. Luigj Gurakuqi, Lezhë 4501

Drejtoria Rajonale AMP Kukës - Dibër

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Kukës ndodhen në ambjentet e DVP Kukës.

Adresa: Lagjia Nr.6, Rr. "Sul Elezi", Kukës

Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Dibër

Zyrat e AMP Dibër ndodhen në ambjentet e DVP Dibër.

Adresa: Lagjia "Gjokë Doçi", Rr. Iljaz Pashë Dibra, Peshkopi

Drejtoria Rajonale AMP Fier - Berat

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Fier ndodhen në ambjentet e DVP Fier.

Adresa: Rr. Koco Plaku, Fier

Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Berat

Zyrat e AMP Berat ndodhen në ambjentet e DVP Berat.

Adresa: Blv. "Republika", Berat

Drejtoria Rajonale AMP Elbasan - Korçë

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Elbasan ndodhen në ambjentet e DVP Elbasan.

Adresa: Rr. Koço Brisku, Elbasan

Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Korçë

Zyrat e AMP Korçë ndodhen në ambjentet e DVP Korçë.

Adresa: Lagjia Nr.1, Blv. "Republika", Korçë

Drejtoria Rajonale AMP Vlorë - Gjirokastrë

Zyrat e Drejtorisë Rajonale të AMP Vlorë ndodhen në ambjentet e DVP Vlorë.

Adresa: Lagjia "Kushtrimi", Rr. Janaq Kilica

Për ankesat kontaktoni 0800 90 90

Zyrat e AMP në Gjirokastrë

Zyrat e AMP Gjirokastrë ndodhen në ambjentet e DVP Gjirokastrë.

Adresa: Lagjia "18 Shtatori"

*** Për ankesat kontaktoni 0800 90 90**

MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT



Denonco paligjshmërinë nga punonjës të:

Policisë së Shtetit
Gardës së Republikës
Shërbimit Zjarrfikës (PMNZSH)

Posta elektronike

ankesa@amp.gov.al

Linja e Gjellbër:

0800 90 90 (pa pagesë)

***Për denoncime në kuadër të Vettingut në Polici: denonco@amp.gov.al**

*** Posta zyrtare: Rruga “Asim Vokshi”, Nr. 19/1, Tiranë**

*** Ankesa me Whatsapp: 0694151511**

*** Zyra e Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP**

*** Zyrat e Drejtorive Rajonale të AMP pranë Drejtorive Vendore të Policisë në Qarqe**

*** Faqja zyrtare në Internet e AMP: www.amp.gov.al**

*** Faqet në rrjetet sociale: AMP në Facebook, Instagram, Twitter dhe LinkedIn**

